

Komiteti për komunitete (KK) 2015


Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) ofron mbështetje për përmirësimin e pjesëmarrjes së komuniteteve në proceset e vendimmarrjes dhe qeverisjes dhe në institucione. Në suazat e këtyre përpjekjeve, OSBE-ja e monitoron rregullisht punën e mekanizmave komunalë për mbrojtjen e komuniteteve. Këto lista me informata kanë si qëllim t'ju ofrojnë akterëve përkatës komunalë dhe institucioneve të nivelit qendror tregues që mund t'u ndihmojnë për t'i identifikuar mangësitë në respektimin e kritereve ligjore dhe për ta përcjellë rritjen e pajtueshmërisë me ato kritere.

Fakte kyçe rreth komitetit për komunitete:

- I mandatar për të siguruar respektimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve, përmes shqyrtimit të politikave dhe veprimeve të autoriteteve komunale dhe dhënies së rekomandimeve përkatëse;
- Komitet obligativ për të gjitha komunat;
- Duhet të përbëhet në radhë të parë nga përfaqësuesit e komuniteteve që janë pakicë numerike në nivel të komunës;
- Duhet të mbledhet të paktën një herë në muaj;
- Dokumentet kryesore: Ligji për vetëqeverisje lokale (nr. 03/L-040, 2008), neni 53; Udhëzimi administrativ nr. 03/2014 i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë; Udhëzuesi për KK-të dhe Termat përkatës të referencës.

Themelimi & Funkzionimi

Komitetet për komunitete janë themeluar në që të gjitha 38 komunat e Kosovës




KK-të që mbledhen rregullisht

*Sipas Termave të referencës (neni 9.1), KK-të duhet të mbledhen të paktën një herë në muaj. KK-të që nuk janë mbledhur rregullisht në vitin 2015: Juniku, Vitia, Rahoveci, Prizreni dhe Mitrovica.

Komitetet e papërfaqësuar


Ndonëse çdo komunitet që banon në komunë duhet të jetë i përfaqësuar në KK, një gjë e tillë nuk ndodhë në shumë KK. Ndër komunitetet që më së shpeshti ngelin të papërfaqësuar janë boshnjakët dhe turqit e Kosovës.

Qasja në burime adekuate*











*Sipas vlerësimit të kryesuesve të KK-ve, (p.sh. transport, kompjuterë, zyra, telefona)

Përbërja gjinore e KK



Performanca në vitin 2015


Përqindja e KK-ve që i realizojnë detyrat themelore*



*Detyra të përcaktuara me kuadrin ligjor dhe të politikave që monitorohen rregullisht nga OSBE

Po Jo

Numri i detyrave themelore të realizuara



Pjesa e parë e 2015 Pjesa e dytë e 2015

Numri i detyrave themelore të realizuara

